



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

U D H Ë Z I M

Nr. 383 datë 11 / 5 / 2005

P Ë R

**ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 854 DATË
17.12.2004 "PËR KRITERET DHE MASËN E PËRFITIMIT TË PAGËS SË
PAPUNËSISË PËR BASHKËSHORTIN/EN E USHTARAKUT AKTIV TË
FORCAVE TË ARMATOSURA"**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 2 të nenit 19 të ligjit Nr.8671, datë 26.10.2000, "Për Pushtetet dhe Autoritetet e Komandimit dhe të Drejtimit Strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të VKM Nr.854, datë 17.12.2004 "Për kriteret dhe masën e përfitimit të pagës së papunësisë për bashkëshortin/en e ushtarakut aktiv të FA, të Republikës së Shqipërisë",

U D H Ë Z O J :

1- Bashkëshortit/es së ushtarakut aktiv (oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist) të Forcave të Armatosura, i jepet pagë papunësie, kur ushtaraku emërohet në detyrë jashtë vendbanimit të tij, brënda apo jashtë vendit dhe plotëson kriteret e përcaktuara në shkronjat "a", "b", "c", "ç" dhe "d" të pikës 1 të vendimit.

2- Bashkëshorti/ja e ushtarakut aktiv kur emërohet në detyrë jashtë vendbanimit të tij të përhershëm brënda dhe jashtë vendit, duhet të dorëzojë dokumentacionin e nevojshëm në strukturën përkatëse ku shërben ushtaraku. Ky dokumentacion është si me poshtë:

a) Në rastin kur ushtaraku emërohet në detyrë jashtë vendbanimit të tij të përhershëm, brënda vendit:

- 1- Kërkesë për trajtim me pagesë papunësie.
- 2- Libreza e punës.
- 3- Vërtetim nga zyra e punësimit dhe komanda e strukture ushtarake.
- 4- Çertifikatë familjare.
- 5- Çertifikatë personale me fotografi.
- 6- Vërtetim që nuk ushtron veprimtari fitimprurëse.
- 7- Vërtetim që nuk trajtohet me ndihmë ekonomike.

b) Në rastin kur emerohet ne detyre jashte vëndit:

- 1- Kërkesë për trajtim me pagesë papunësie.
- 2- Libreza e punës.
- 3- Urdhëri i Ministrit te Mbrojtjes për emërimin e bashkëshortit ne detyre jashtë vëndit.
- 4- Vërtetim papunësie nga struktura e misionit jashtë vëndit.
- 5- Çertifikatë familjare.
- 6- Çertifikatë personale me fotografi.
- 7- Vërtetim që nuk ushtron veprimtari fitimprurëse.
- 8- Vërtetim që nuk trajtohet me ndihmë ekonomike.

Dokumentat e mësipërme të gjermës "b", kur ushtaraku emërohet në detyrë jashtë vëndit, struktura përkatëse i percjell zyrtarisht në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes.

3- Paga e papunësisë jepet në emër të bashkëshortit/es, në strukturën e Forcave të Armatosura, ku shërben apo ka shërbyer ushtaraku i shërbimit aktiv, ne rezervë, lirim apo që ka vdekur.

Për ushtarakun aktiv të Forcave të Armatosura të emëruar me detyrë jashtë vëndit, paga e papunësisë në emër të bashkëshortit/es, ti jepet në Ministrinë e Mbrojtjes. Në rastet kur ushtaraku ka qënë i emëruar me detyrë jashtë vëndit në momentin e daljes në rezervë, lirim apo që vdes, kjo pagesë papunësie do të vazhdoje ti jepet në Ministrinë e Mbrojtjes.

4- Masa e pagesës së papunësisë, për ushtarakët që kanë përfutuar në bazë të paragrafit të parë dhe të dytë të shkronjës "b", të pikës 3 te VKM nr. 86, datë 12.3.1992, të jetë 100% e pagës minimale në shkallë vendi në bazë të pikës 3/a te VKM nr.854, date 17.12.2004.

Ndersa për ushtarakët që kanë përfutuar në bazë të paragrafit të tretë, të shkronjës "b", të VKM nr.86, date 12.3.1992, ata do të vazhdojnë të trajtohen me pagesën që kanë përfutuar, por jo më pak se 120 % e pagës minimale në shkallë vendi, në bazë të pikës 3/b te VKM nr.854, datë 17.12.2004 dhe jo më e madhe se 15090 leke, deri në momentin që masa e pagesës prej 120 % te pagës minimale në shkallë vendi, nuk e kalon vlerën e mësipërme.

Në rastin kur masa e pagesës prej 120 % të pagës minimale në shkallë vendi, e kalon vlerën prej 15.090 lekë, atëherë trajtimi me pagesë papunësie i ushtarakëve që kanë përfutuar në bazë të paragrafit të trete, të shkronjës "b", të VKM nr. 86, date 12.3.1992, të bëhet në masën e përcaktuar në pikën 3/b të VKM nr.854, date 17.12.2004.

5- Kur ushtaraku ka përfutuar shtesë page për bashkëshorten sipas VKM Nr.86 datë 12.03.1992, dhe del ne rezervë, lirim apo vdes, pas datës 14.05.2004 (duke perfshire dhe këtë datë), atëherë bashkëshortja do të vazhdojë të përfutojë pagesën e papunësisë deri në 7 vjet, duke filluar nga data 14.05.2004, por jo më shumë se 15 vjet.

6- Kur ushtaraku ka përfutuar shtesë page për bashkëshorten/in sipas VKM Nr.86, datë 12.03.1992, dhe ka dale në rezervë, lirim apo vdes, para datës

14.05.2004, bashkeshortja/ti nuk do të vazhdojë të përfitojë pagesë papunësie.

7- Ushtaraku në rezervë ose në lirim, bashkëshorti/ja e të cilit ka përfituar pagën e papunësisë sipas VKM Nr.86, datë 12.3.1992 apo VKM nr.854, date 17.12.2004, kur vdes, bashkeshortja/ti do të vazhdojë të trajtohet me pagesë papunësie deri më 7 vjet, duke filluar nga data 14.05.2004, por jo më shumë se 15 vjet.

8- Pagesa e papunësisë së bashkëshortit/es së ushtarakut, të bëhet sipas modelit 20 të list-pageses të miratuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

9- Kontributi i sigurimeve shoqërore e shëndëtesore të llogaritet nga data 14.05.2004, në nivelin e pagës minimale mujore të miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe është i njëjtë për të gjitha nivelet e pagesës së papunësisë.

10- Të gjitha strukturat ushtarake të Forcave të Armatosura përpara se të bëjnë emërimë në detyrë jashtë vendbanimit të përhershëm, brenda apo jashtë vendit të ushtarakëve dhe të cilëve iu lind e drejta e përfitimit të pagesës së papunësisë sipas VKM Nr.854, datë 17.12.2004, të marrin miratimin nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm.

11- Ne Komandat e Forcave, Komandat Mbështetëse, Repartet autonome, në institucionet ushtarake, degët e personelit përgjigjen për administrimin, evidentimin, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e dokumentacionit të bashkëshortit/es të ushtarakut, që trajtohen me pagesë papunësie.

12- Ne Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të trajtojë praktikat administrative për përfitimin e pagesës së papunësisë të ushtarakëve të transferuar në Ministrinë e Mbrojtjes e SHPPFA, si dhe të emëruar me detyrë jashtë vendit, ndërsa administrimi, evidentimi, ruajtja e mirëmbajtja e dokumentacionit të pagesës së papunësisë dhe veprimet në regjistrin themeltar, të kryhen nga Sektori i Administrimit të Dokumentave në Drejtorinë e Personel-Organizimit të Shtabit të Përgjithshëm.

13- Përgjigjet për zbatimin e këtij Udhëzimi, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Personel Organizimit, Drejtoria e Financës, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve të Mbrojtjes, Drejtoria e Administratës dhe e Shërbimeve në Ministrinë e Mbrojtjes, Drejtoria Juridike, Komandat e Forcave, Komandat Mbështetëse, Komandat e njësisë të reparteve autonome dhe të institucioneve ushtarake në vartësi të Ministrisë së Mbrojtjes.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 14.05.2004.

MINISTRI

PANDELI MAJKO

